



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 635 Prot.

Roskovec, më 31.01 2024

VENDIM

NR 7 DATË 30.01 2024

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI PËRMIRËSIMI I
KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË
PAFAVORIZUARA**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 24, ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar; VKM-së 454, datë 03.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Udhëzimit nr. 31 të Ministrisë së Financave, datë 18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga Buxheti i shtetit për programet e strehimit"; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miralimit nga organet e vetqeverisjes vendore"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Listës emërore të familjeve të pafavorizuara për t'u përfshirë në programin "*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara*".
- 2- Ngarkohet Komisioni i strehimit, për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista emërore e familjeve që plotësojnë kriteret.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

